
Dear supporters of Gjirokastra and GCDO,

It is with great pleasure that we inform you of our latest achievements. Over the past three months GCDO has experienced several noteworthy successes. We hosted the IV National Heritage and Artisan Fair held here in Gjirokastra. GCDO's work was nominated for a prestigious award, The Aga Khan Award for Architecture. We inaugurated the new Vodafone Albania Foundation project which helps to train Gjirokastra youth in the art of iso-polyphonic singing. Finally, we successfully completed the first phase of a new museum project for the castle, which will focus on the history of Gjirokastra and the surrounding region. We invite you to read more in our newsletter.

Thank you,

Director
Sadi Petrela

1. National Heritage and Artisanship Fair "Gjirokastra 2010."



Craftsmen thronged the streets of Gjirokastra in the first few days of October, for an event that brought to mind the heyday of this regional market town. This fourth national artisan fair, organized by the GCDO, saw over 100 artisans and craftsmen come together to exhibit and sell their crafts and to celebrate the National and European Heritage days. The event, which gets substantially bigger every year, demonstrates that crafts are alive in Albania and becoming increasingly diversified. There were handcrafts from Kosovo, agribusinesses from Përmet, Butrint mosaic stones, Gjirokastra dairy products, bio-products from Puka and

Të nderuar dashamirës të Gjirokastrës dhe organizatës sonë,

Kam kënaqësinë t'ju bëjmë të ditura përpjekjet tona më kryesore të tre muajve të fundit. Kanë qenë muaj shumë të frytshëm me plot aktivitete që nga Panairi IV i Trashëgimisë dhe Artizanatit në Gjirokastrë, vlerësimi i GCDO-së nga juria e një çmimi prestigjioz ndërkombëtar si Aga Khan Award for Architecture, Projekti me Fondacionin Vodafone Albania për mësimin e këngës polifonike nga nxënësit e shkollave, deri tek përfundimi i fazë së parë të përpjekjeve për të ndërtuar një muze të ri për historinë e Gjirokastrës dhe rajonit të saj. Ju ftoj të lexoni më shumë në Buletinin tonë.

Faleminderit,

Drejtor
Sadi Petrela

1. Panairi i Trashëgimisë Kulturore dhe Artizanatit "Gjirokastra 2010."



Në ditët e para të tetorit, zejtarë dhe artizanë, u mbledhën në sokakët e Pazarit të Gjirokastrës, duke i dhënë atij shkëlqimin e dikurshëm si qendër rajonale tregtare. Ky edicion i katërt i panairit të artizanatit, organizuar nga GCDO, bashkoi mbi 100 artizanë nga gjithë Shqipëria për të ekspozuar dhe shitur produktet e tyre si dhe për të festuar ditën e Trashëgimisë Kombëtare dhe ditët e Trashëgimisë Europiane. Ky event, që bëhet më i madh nga viti në vit, tregon se artizanati shqiptar është i gjallë, po zhvillohet e po merr larmi: veç artizanatit dhe produkteve blegtorale lokale, pjesëmarrësit përfaqësonin artizanatin e Kosovës, agrobiznesin e Përmetit, mozaikun e gurit nga Butrinti, prodhimet bio nga Puka, qilimat e Shkodrës etj. Ky ishte përsëri një rast i mirë dhe produktiv për të shkëmbyer përvojë dhe për të zhvilluar ide të reja. Çmimi i parë i panairit iu dha Beti Muharremit si përfaqësuese e 80

Shkodra carpets. The opportunity for craftspeople to mingle, see each other's work, develop new ideas and share experience is proving, once again, very successful and popular. This Fair's novelty was the presence of Bio-products, the traditional way of producing cheese, collecting herbs and drying food is considered part of national heritage. Prizes for best crafts were awarded to exhibitors from Kosovo, Shkodra and Gjirokastra. First prize went to Beti Muharremi representing some 80 groups of women artisans from Kosovo as part of the "Dera e Hapur" association.

The Fair, which was jointly sponsored by the Ministry of Tourism, Culture, Youth and Sports (MTCYS) was inaugurated by the Vice Minister of MTCYS, Suzana Turku and the Mayor of Gjirokastra, Flamur Bime. The Ambassador for the United Kingdom of Great Britain and Northern Ireland, Fiona McIlwham, also took part in the second day. Other agencies supported the Fair including SASA (Sustainable Agricultural Support for Albania from Swiss Cooperation Fund), MADA (Mountain Areas Development Agency through the Gjirokastra Mountain Areas Forum), CESVI, UNDP's program for Kukes Regional Tourism and Environmental Development, the Butrint Foundation, the Association of the Albanian Artisans, the Destination Management Organization from Korca etc.

The two day event also included the Round Table, an annual, event which focused on how heritage tourism can bring local development. A variety of development agencies (GTZ, USAID's Growth Albania Programme, CESVI) representing experiences from Kukës to Përmet participated in the event, which proved a very useful forum for the exchange of ideas.

2. GCDO's work is internationally recognized and appreciated - candidate for the world wide known "Aga Khan Award for Architecture", 2010.

GCDO's work for saving and revitalizing Gjirokastra is selected to be one of 19 nominees short-listed out of 401 entrants for this year's prize "Aga Khan Award for Architecture". This is such an important prize that the nominees list was broadcasted in 800 media worldwide. The selection of GCDO was made after two reporters, the architect restorer Michele Lamprakos and a cameraman/journalist Max Gonzales, visited for several days Gjirokastra to evaluate GCDO's work.

The recognition and publicity will give extra impetus to the efforts to save Gjirokastra, and will help bring the plight of

artizaneve nga Kosova, pjesëtare të shoqatës "Dera e Hapur".

Panairi i bashkëfinancuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve u inaugurua nga zv/ministria e MTKRS Suzana Turku dhe Kryetari i Bashkisë së Gjirokastrës, Flamur Bime. Ambasadorja Britanike në Tiranë, Fiona McIlwham, nderoi me pjesëmarrjen e saj ditën e dytë të panairit. Ky event u mbështet dhe nga donatorë të tjerë si SASA (Mbështetja për Bujqësinë e Qëndrueshme në Shqipëri nëpërmjet Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim), MADA (Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore përmes Forumit të Zonave Malore Gjirokastrë), CESVI, programi i UNDP për Zhvillimin Turistik dhe Mjedisor për rajonin e Kukësit, Fondacioni Butrinti, Shoqata e Artizanëve Shqiptarë, Shoqata për Menaxhimin e Destinacionit nga Korça etj.

Aktivitetet dyditore përfshinë, si zakonisht, edhe një tryezë të rrumbullakët, që këtë vit iu kushtua ndikimit që mund të ketë turizmi kulturor në zhvillimin lokal. Shumë agjenci zhvillimi (GTZ, programi i USAID Rritje Shqipëri, CESVI) morën pjesë në këtë aktivitet duke sjellë përvoja nga Kukësi e deri në Përmet të cilat rezultuan shumë të vlefshme për shkëmbim eksperiencash dhe idesh.

2. Puna e GCDO-së njihet dhe vlerësohet në botë – kandidatë për çmimin e mirënjohur ndërkombëtar "Aga Khan Award for Architecture", 2010.

Programi i GCDO-së për shpëtimin dhe rijetëzimin e Gjirokastrës historike përfshihet ndër 19 projektet më të mira të Çmimit për Arkitekturën Aga Khan (Aga Khan Award for Architecture) mes 401 konkurrentëve nga e gjithë bota. Një specialiste restaurimi, Michele Lamprakos dhe një kameraman, Max Gonzales qëndruan për dy javë në Gjirokastrë për të parë nga afër rezultatet e punës që Organizata për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Gjirokastrës (GCDO) ka arritur në 9 vjet të veprimtarisë së saj në qytetin e gurtë, duke pasur edhe mbështetjen e partnerëve të saj dhe komunitetit lokal.

Ky vlerësim si dhe publiciteti që e shoqëron do të ndihmojnë në shtimin e vëmendjes ndërkombëtare ndaj problemeve për ruajtjen dhe zhvillimin e Gjirokastrës. Lajmi i përzgjedhjes u transmetua nga 800 media të ndryshme në gjithë botën radiotelevizive, gazeta dhe media në Web. GCDO dhe

the city to international attention. GCDO and Gjirokastra, along with the 18 other nominees, will appear in the featured documentary to be broadcast on BBC World Service by the end of this year.

The Aga Khan Award for Architecture is a major international prize, given every 3 years, that recognizes the work of architects, builders and organizations who work in the field of architecture since 1980.

For more information please visit the Ada Khan website: <http://www.akdn.org/architecture/project.asp?id=3990>

3. Gjirokastra's young generation is trained on isopolyphonic singing.



GCDO took an important new initiative to keep the isopolyphonic singing alive in Gjirokastra. The project, launched at the beginning of October, has been sponsored by Vodafone Albania Foundation and will see the renowned iso-polyphonic singer Roland Çenko teaching a group of young pupils isopolyphonic songs of Gjirokastra and the region. Vasil Tole, a well known expert and academic of the genre, addressed the audience while thanking generations of iso-polyphonic singers from Gjirokastra who have helped conserve the traditions. Iso-polyphonic singing has been recognized since 2005 as an Intangible World Heritage by UNESCO. The British Ambassador in Tirana, Fiona McIlwham participated in the opening ceremony said that "Heritage is not something that should be just kept in museums, heritage should be lived." The young group will be trained in the newly restored Omarate House where the Artisan Incubator is located. The iso-polyphonic young singers traditional costumes are being prepared by Gjirokastra women artisans.

Gjirokastra, së bashku me 18 kandidatët e tjerë, do të jetë në një dokumentar të përgatitur nga programi ndërkombëtar i BBC-së i cili do të shfaqet në fund të vitit.

Çmimi për Arkitekturën Aga Khan është nga më të mëdhenjtë në shkallë ndërkombëtare dhe jepet një herë në tre vjet për individë dhe organizata që punojnë në fushën e arkitekturës. Për më shumë informacion shihni ju lutemi në:

<http://www.akdn.org/architecture/project.asp?id=3990>

3. Kënga isopolifonike vjen tek të rinjtë e Gjirokastrës



GCDO mori nismën e rëndësishme për të ndihmuar në përjetësimin e këngës isopolifonike, e cila gjeti mbështetjen financiare të Fondacionit Vodafone Shqipëri. Projekti nisi në fillim të tetorit dhe parashikon që këngëtari i njohur gjirokastrit Roland Çenko t'i mësojë këngën polifonike nga Gjirokastra dhe rajoni një grupi të rinjsh të përzgjedhur nga shkollat. Akademiku Vasil Tole, ekspert i njohur në këtë fushë, duke folur në ceremoninë përuruese, falënderoi për kontributin që Gjirokastra ka dhënë dhe jep për ruajtjen e kësaj tradite. Ambasadorja britanike në Tiranë Fiona McIlwham, vuri në dukje se "Trashëgimia nuk është diçka që u takon muzeve, por ajo duhet të jetojë e të jetë e gjallë tek njerëzit". Isopolifonia shqiptare është pjesë e Trashëgimisë Botërore Jomateriale të UNESCO-s që nga viti 2005. Grupi i të rinjve, i formuar pas përzgjedhjes së parë, do të bëjë prova në godinën Omarate të sapo restauruar, ku është krijuar edhe një qendër artizanale, në të cilën, artizanet vendase do të qepin kostumet tradicionale për këngëtarët e rinj.

4. Shtëpia Babameto - nis restaurimi

Restaurimi në shtëpinë Babameto, kategoria II në pazarin e Gjirokastrës nisi në gusht si pjesë e projektit "Gjirokastra

4. The Babameto houses Restorations are underway.

The restoration of the Babameto House, category 2 in the Bazaar of Gjirokastra started this August as part of the "Gjirokastra 2009-2011" project between the Swedish Foundation, Culture Heritage without Borders, (CHWB), and the GCDO. This is the first of two important historical buildings to be restored. Integral to this process has been the Cultural Heritage without Borders "restoration camps" which has seen students from all over the Balkans and the Universities of Tirana attending two-week training in practical building conservation as well as attending lectures from international speakers. The latest camp was in September. The restoration will start very soon in another building even more important-the Babameto Category one. Meanwhile, GCDO is developing a business plan for the future usage of the Babameto houses.

5. "History between Honour and Honesty."



This was the title of two public events in Tirana and Gjirokastra organized by GCDO on the 12th and 14th of October about the question if and how Albania's communist period should be presented in the country's museums. Special guests of the events, which took place within the framework of the German October, were two historians, Hans-Jörg Chzech and Peter Jahn, who mastered the difficult task of bringing two different views on history together when they designed the concepts for the German Historical Museum and the German-Russian Museum in Berlin. Both events were attended by high-level decision-makers as well as the general public, and brought about lively discussions. Having visited Gjirokastra's castle, museums and Zekate House, the German experts made valuable suggestions on how to develop Gjirokastra's museum infrastructure, including the Gjirokastra

2009-2011", bashkëpunim i fondacionit Suedez Trashëgimia Kulturore pa Kufinj (CHWB) dhe GCDO-së. Ky është një nga dy restaurimet e planifikuara të bëhen. Pjesë integrale e projektit janë edhe kampet ndërkombëtare të restaurimit që organizon CHWB, në të cilin studentë nga Tirana dhe vende të ndryshme të Ballkanit ndjekin një trajnim dyjavor në konservimin e ndërtesave historike, shoqëruar me leksione nga specialistë ndërkombëtarë. Kampi i radhës u zhvillua në muajin shtator. GCDO po përgatit planet e biznesit për futjen në përdorim (rijetëzimin) e dy ndërtesave Babameto.

5. "Historia mes nderit dhe ndershmërisë"



Nën këtë titull dy konferenca u organizuan nga GCDO në Tiranë dhe Gjirokastër rreth çështjes nëse duhet dhe si Shqipëria mund të paraqesë në muzetë e saj periudhën komuniste të historisë kombëtare. Këto konferenca u organizuan në kuadrin e "Tetorit Gjerman" në 12 dhe 14 tetor. Të ftuar të veçantë ishin historianët gjermanë Hans-Jörg Chzech dhe Peter Jahn, që kanë përballuar me sukses sfidën e gjetjes së gjuhës së përbashkët mes dy pikëpamjeve të kundërta për historinë në Muzeun Historik Gjerman dhe Muzeun gjermano - rus në Berlin. Në diskutimet e gjalla morën pjesë studiues dhe specialistë si dhe titullarë të institucioneve përkatëse. Pasi vizituan Kalanë dhe muzetë e Gjirokastrës, specialistët gjermanë bënë sugjerime me vlerë për mundësitë e Gjirokastrës për të pasur më shumë muze, përfshirë muzeun historik të qytetit dhe luginës së lumit Drino, parashikuar të bëhet vitin e ardhshëm nga GCDO.

6. Përfundoi restaurimi i Galerisë së Muzeut në Kalanë e Gjirokastrës

Museum on which GCDO is working on in partnership with the local and central government.

6. The restoration of the Museum Gallery in Gjirokastra Castle is completed.

After several months of restoration works the Gallery is ready to host activities. Three exhibitions have opened so far and more are planned. The area restored is 375 square meters, which provides a unique space for exhibiting a Museum for Gjirokastra and the Drino Valley. The surface of walls restored is at about 1600 square meters. GCDO has already started to collect opinions on the new Museum: from high school youths to expert of history and museography in Gjirokastra and Tirana, to foreign experts, their opinions will contribute to the Museum proposal which will be delivered on the City Council for preliminary approval. A scientific group of experts will refine the Museum concept and make it ready for the National Museum Committee of the Ministry of Tourism, Culture, Youth and Sports.

The project of the making of Gjirokastra's new museum is funded by various donors. Donors include United States Ambassador's Cultural Preservation Fund, the Packard Humanities Institute and Fidelity Charitable Gift Fund.

7. Training young wood and stone carvers through Swiss Cooperation Fund support.

Gjirokastra is a testimony of the great skills possessed by the stone and wood carvers who built it. Today, the number of these skilled masters is diminishing and may vanish before too long making the town's restoration challenge even more difficult. GCDO will be supported by Swiss Agency for Development and Cooperation in training ten stone and wood carvers from well known Gjirokastra masters. The project aims to keep the traditions alive while supporting the youth employment, restoration and economic regeneration of the town. The young apprentices will be selected through a competition and their training will continue for 10 months.

Pas disa muajsh pune restauruese Galeria është e gatshme të presë aktivitete të ndryshme kulturore artistike. Tri ekspozita janë hapur deri tani në mjediset e saj. Galeria me një sipërfaqe prej 375 metra katror, ku ndër të tjerat u restauruan mbi 1600 metra katror mure, përfaqëson tani një hapësirë shumë të përshtatshme për një muze kushtuar historisë së Gjirokastrës dhe luginës së lumit Drino. GCDO ka nisur ndërkohë konsultimet në të cilin përfshihen të rinj të shkollave të mesme, ekspertë të muzeumologjisë nga Gjirokastra e Tirana dhe ekspertë të huaj. Rezultatet do të pasqyrohen në konceptin për përmbajtjen dhe paraqitjen e muzeut, i cili do të paraqitet për miratim fillimisht në Këshillin e Qytetit. Një grup ekspertësh pastaj do të bëjë projektin dhe dizajnin përfundimtar që do të shqyrtohet nga Komiteti Kombëtar i Muzeve në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Projekti për muzeun e ri është financuar nga disa donatorë, ndër të tjera Fondi për Ruajtjen e Trashëgimisë i Ambasadorit të Shteteve të Bashkuara, Packard Humanities Institute dhe Fidelity Charitable Gift Fund.

7. Trajnimi i gur dhe drugdhendësve të rinj me mbështetjen e Swiss Cooperation Fund

Gjirokastra historike është dëshmi e aftësive të jashtëzakonshme të dru dhe gurgdhendësve. Sot numri i mjeshtrave aktivë në këto mjeshtëri është pakësuar, duke vështirësuar planet për mirëmbajtjen dhe restaurimin e qytetit. GCDO me mbështetjen e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim do të organizojë trajnimin e 5 të rinjve në secilën nga këto mjeshtëri. Projekti synon të mbajë të gjallë dhe zhvillojë traditat në këtë fushë, duke kontribuar në përpjekjet për restaurimin e qytetit dhe punësimin e brezit të ri. Kandidatët e rinj do të përzgjidhen nëpërmjet një konkurimi të hapur dhe trajnimi i tyre do të vazhdojë për një periudhë prej 10 muajsh.
